

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFQISSHËM
DËLËKA JE PRAVNO-SNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / UROŠEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

Më
Datë

10. 09. 2018

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni

Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Hakile Ilazi si dhe procesmbajtësen Ganimete Avdiu, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të pandehurve [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për shkak se në vazhdim dhe në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe për të pandehurin [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale detyrimi nga neni 267 par.1 të KPK-së, si dhe kundër të akuzuarve [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale Pranim i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së, sipas Aktakuzave: PP.nr.855/2011 e dt.27.10.2011, PP.nr.952/2011 e dt.21.11.2011, PP.nr.956/2011 dt.21.11.2011, PP.nr.981/2011 dt.23.11.2011, PP.nr.1066/2011 dt.23.11.2011, PP.nr.1072/2011 dt.23.11.2011, PP.nr.1076/2011 dt.23.11.2011, PP.nr.114/2012 dt.19.06.2012, PP.nr.707/2011 dt.04.04.2012, PP.nr.932-3/2012 dt.19.09.2012, PP/II.nr.1218-4/2013 dt.18.12.2013, PP/II.nr.1222-6/2014 dt.13.05.2015, PP/II.nr.1226-4/2014 dt.08.06.2015, PP/II.nr.3049-1/2014 dt.09.12.2015, PP/II.nr.1221-05/2014 dt.13.06.2016, PP/II.nr.2509-4/2015 dt.16.09.2016, të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 21.06.2018, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani, të pandehurve, si dhe mbrojtësit i të pandehurit [REDAKTUAR] Avokati [REDAKTUAR] me autorizim, më datë 21.06.2018 mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin ndërsa me datë 20.07.2018 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Kundër të akuzuarve :

1. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rr. "[REDAKTUAR]" nr. [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, punëtor fizik, ka të kryer shkollën fillore, gjendjes së varfër ekonomike.

2. [REDACTED], nga Ferizaj, Rr. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] baba i një fëmije shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.
3. [REDACTED], nga Ferizaj, Rr. [REDACTED], nr. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] i vajzërisë [REDACTED] shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion biznesmen.
4. [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED], i lindur më [REDACTED] në [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED] shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion punëtor fizik, ka të kryer shkollën e mesme i gjendjes së varfër ekonomike.
5. [REDACTED], nga Fushë Kosovë, Rr. [REDACTED], nr. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] i vajzërisë [REDACTED] shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i tre fëmijëve, ka të kryer fakultetin e shkencave matematikore, pronar i një hoteli i gjendjes së mesme ekonomike.
6. [REDACTED], nga Ferizaj, Rr. [REDACTED], nr. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i një fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion kuzhinier.
7. [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED], i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] i vajzërisë [REDACTED] shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion tregtar.
8. [REDACTED] nga Suhareka, Rr. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] i vajzërisë [REDACTED] shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme i gjendjes së v rërekonomike, i papunësuar.
9. [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED], i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], ashkali shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion tregtar.

Të akuzuarit [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED]

JANË FAJTOR

Sepse:

1.1 Me dt.23.shkurt.2011, rreth orës 00,50, në lokalit " [REDACTED] ", në rr."Hamzë Jashari", në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm, për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në atë mënyrë që pas një marrëveshje paraprake në mes tyre, kanë shkuar tek lokali pronë të dëmtuarit [REDACTED], i pandehuri i parë me një hebull ka hapur derën e lokalit dhe së bashku me të pandehurin e dytë kanë hyrë brenda lokalit kurse i pandehuri i tretë ka bërë roje jashtë lokalit, nga aty kanë marrë cigare të llojit "Vinston", "Ronhill", "Davidof", "Klasik" dhe 12 shishe alkool të llojit "Sminorf", "Xhek Daniells" dhe "Shtok", ku një pjesë e këtij malli ja shesin të pandehurit [REDACTED].

1.2 Me dt.24 mars 2011, rreth orës 02.30, në lokalit " [REDACTED] ", në rr."Dëshmorët e Kombit", në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në atë mënyrë që në bashkëkryerje me përdorimin e forcës kanë hapur derën e lokalit, kanë depërtuar brenda në lokalit pronë e të dëmtuarit [REDACTED] dhe nga aty kanë marrë 100 orë dore, disa bateri dhe një kuti me rripa të orëve, në vlerë të përgjithshme rreth 2.000€.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Të akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED]

1.3 Me dt.06 mars 2011, në shitoren NTP, [REDACTED] në rr. "Hamzë Jashari", në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në atë mënyrë që në bashkëkryerje, me përdorimin e forcës kanë hapur derën e lokalit, kanë depërtuar brenda në lokalit pronë e të dëmtuarit [REDACTED] dhe nga aty kanë marrë 5 shishe alkool të llojit "Xhek Daniells" cigaretë llojeve të ndryshme

në vlerë 250€, sheqer dhe vaj në vlerë 70 € si dhe 8€para të metalta dhe largohen nga aty.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse:

1.4 Në datë të pacaktuar të muajti mars 2011, në motelin [REDAKTUAR], në Fushë Kosovë, ka blerë nga i pandehuri i parë dhe i dytë, pije alkoolike dhe atë24 shishe raki rrushi, 6 shishe "Lloz", 3 shishe "Smirnof", një "Xhek Daniells", të gjitha në vlerë prej 300€ edhe pse e ka ditur se sendet janëpërfituruar me anëtë kryerjes se veprës penale vjedhjes.

Me të cilën kreu veprën penale praimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së.

Të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Sepse:

2.1 me date 31.12.2010, rreth orës 08.30 në Feriza, në rr."Besim Rexhepi", në bashkëkryerje me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshem, në atë mënyrë që me qëllim të përdorimit të forcës kanë hapur lokalin e të dëmtuarit [REDAKTUAR], janë futur brenda dhe nga aty kanë marrë: dy shtëpiza kompjuteri, dy monitorë, një fotokopje, një printer dhe një resever të gjitha në vlerë prej 1818€ dhe janë larguar nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

2.2 me dt.24.01.2011, rreth orës 9.55, në Ferizaj, në rr."Kemajl Hetemi", në bashkëkryerje me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetes t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës kanë hapur lokalin [REDAKTUAR]- pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marrë, 1 TV plazma të tipit "Sëistek", 1 laptop i

tipit "Acer" si dhe 15 kilogramësh, të gjitha në vlerë 760€ dhe janë larguar nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

2.3 me dt.21.02.2011, rreth orës 8.10, në Ferizaj, në rr."Xhemë Gostivari", në bashkëkryerje, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetes t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës e kanë hapur derën e lokalit [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe aty kanë marrë 1 TV plazma e tipit "LG" në vlerë rreth 386€ dhe janë larguar nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

2.4 me dt.22.02.2011, rreth orës 00.30, në Ferizaj, në rr."Ahmet Kaçiku", në bashkëkryerje, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetes ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës kanë hapur derën e kafiterisë "[REDAKTUAR]" pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marrë 30 kilogram mish, 10 pije alkoolike, 2 nxehtë-kaloriferë, të gjitha në vlerë rreth 550€ dhe janë larguar nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Sepse:

2.5 Me dt.27.01.2011, rreth orës 8.10, në rr."Remzi Hoxha", në bashkëkryerje me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetes t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës kanë hapur derën e lokalit-pronë të dëmtuarit [REDAKTUAR] kanë depërtuar brenda 5 monitorë të llojit "Daeëoo", 2 TV Grundig, 1 TV Samsung dhe 1 TV JVC, të gjitha në vlerë 1620€ dhe janë larguar nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse:

2.6 Me dt.09.03.2011, rreth orës 7.00, në Ferizaj, në rr."Ahmet Kaçiku", me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetes t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës ka hapur derën e kafiterisë "[REDAKTUAR]", ka depërtuar brenda dhe nga aty ka marrë: ITV plazmae tipit "Daeöoo" dhe 300€ para kesh, të gjithë në vlerë 1800€ dhe është larguar nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

Me të cilën kreu veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarve, [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Sepse:

3.1 Me dt.09.03.2011, rreth orës 01.00, në rr."Epopejæ Jezercit", në Qendren Tregtare "[REDAKTUAR]", në kafiterinë "[REDAKTUAR]" në Ferizaj pronë e të dëmtuarit "[REDAKTUAR]" në bashkëkryerje, me qëllim që me vërvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetes t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës, kanë thyer derën e lokalit kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marr një TV "Samsung" me vlerë 800 euro dhe një telefon "Nokia" me vlerë 100 euro dhe largohen nga vendi i ngjarjes.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarve [REDAKTUAR]

Sepse:

4.1 Me datë 06.02.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën "D. Kombit" në Ferizaj, përkatësisht në kioskun e NTP- [REDAKTUAR] pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes dhe pasi kanë depërtuar brenda kanë marrë cigare të ndryshme 35 boksa, në vlerë sipas të dëmtuarit 600€ dhe një sasi të kafes së pa bluar.

4.2 Me datë 06.02.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën "Ahmet Kaçiku" në Ferizaj, përkatësisht në marketin [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes dhe pasi kanë depërtuar brenda kanë marrë nga arka 300€ para të gatshme, 3 copë aparata digjital "Fuji-film", në vlerë prej 300€, Nes Kafe të llojeve të ndryshme në vlerë prej 300€, çokollata "Millka", në vlerë prej 100€, si dhe cigare të ndryshme në vlerë prej 1000€.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse:

4.3 Me datë 06.02.2011 në kohë të pacaktuar, në Ferizaj, kishte blerë nga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] një sasi të kafes së pa bluar, çokollata "Millka" 66 copë, 100 paketa të cigarevetë llojeve të ndryshme dhe 13 pako Nes Kafe pa u siguruar për prejardhjen e të njëjtave, edhe pse ka mundur ta dijë se të njëjtat janë vënë në dorë me anë të vjedhjes, sendet e konfiskuara iu janë kthyer pronarëve.

Me të cilën ka kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nganeni 272 par.2 të KPK-së.

Kundër të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Sepse:

5.1 Me dt.15.04.2013 pas mesnate në rrugën “Besim Rexhepi”, në Ferizaj saktësisht në shkollënteknike në objektin përcjellës i cili shërben për praktikë të nxënësve, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës kanë thyer një dritare të shkollës, përmes saj kanë depërtuar në kabinetin e shkollës dhe nga aty kanë marrë pajisje të ndryshme si aparat saldues dhe aparate të tjera, pjesëtë gypave, kablllo të ndryshme që shërbejnë për mbajtjen e praktikës në kabinetet e shkollës.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Sepse:

6.1 Me datë 04.11.2011 në kohëtë pacaktuar, në rrugën “Besim Rexhepi”, në Ferizaj, përkatësisht në lokalin [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes, kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë 50 shishe pije alkoolike, në vlerë prej 500€.

6.2 Me datë 12.12.2011 në kohë të pacaktuar, në rrugën “Besim Rexhepi”, në Ferizaj, përkatësisht në lokalin [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes, kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë para të metalta rreth 70€ dhe 45 pako pije “Redbull” në vlerë prej 1170€.

6.3 Me datë 18.11.2010 në kohë të pacaktuar në rrugën “Ahmet Kaçiku”, në Ferizaj përkatësisht në lokalin NTP [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarës [REDAKTUAR] me

qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes, kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë artikuj të ndryshëm si : këpucë për femra, sandale të ndryshme, pizhame për femra dhe rroba për fëmijë në vlerë të përgjithshme sipas të dëmtuarës prej 800€.

6.4 Me dt. 03.03.2011, rreth orës 04.15, në rrugën “Ahmet Kaçiku” në Ferizaj përkatësisht në lokalin NTP [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarës [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes dhe nuk kishin marrë asgjë sepse ishin larguar pasi ishte aktivizuar alarmi.

6.5 Me datë 14.03.2011, në kohë të pacaktuar në rrugën “Enver Topalli”, në Ferizaj përkatësisht në lokalin-minimarketin [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes, kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë një arkë në vlerë prej 150€, 40€ para të metalta si dhe cigare të llojeve të ndryshme.

6.6 Me datë 26.03.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën “Ejup Statovci”, në Ferizaj, përkatësisht në lokalin NTP [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë nga arka 100€ para të metalta, cigare të llojeve të ndryshme në vlerë 350€, shampona “Palmolive” në vlerë 40€, vaj në vlerë 30€ dhe qaj në vlerë prej 20€.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse:

7.1 Me datë 15.01.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën “Ahmet Kaqiku” në Ferizaj, përkatësisht në lokalit të Kompanisë së Sigurimeve [REDAKTUAR], me përgjegjës [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, i pandehuri pasi ka hapur me forcë derën e hyrjes, ka depërtuar brenda dhe ka marrë 2 kompjuter të markës “Dell”, një lloptop të markës “Toshiba”, në vlerë sipas të dëmtuarit 1700€.

7.2 Me dt.21.01.2011, në kohë të pacaktuar, në rrugën “D. Kombit”, në Ferizaj, përkatësisht në lokalit për servisimin e ashensorëve pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit i pandehuri ka hapur me forcë derën e hyrjes ka depërtuar brenda dhe ka marrë 2 kompjuter të markës “Compaq”, një televizor Samsung, dy UPS, në vlerë të përgjithshme sipas të dëmtuarit 1.360 €.

7.3 Me datë 19.03.2011, në kohë të pacaktuar në rrugën “Besim Rexhepi”, në Ferizaj, përkatësisht në lokalit –servisin [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit i pandehuri ka hapur me forcë derën e hyrjes, ka depërtuar brenda dhe ka marrë 7 copë televizor të markës Sek, Samsung, Hentrex, Tompson, LG, Techno Trend dhe Keymat në vlerë të përgjithshme sipas të dëmtuarit prej 2.000€.

Me të cilën kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse:

7.4 Me datë 19.03.2011 në kohë të pacaktuar, në Fushë Kosovë kishte blerë nga [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] 7 televizor të markës Sek, Samsung, Hentrex, Tompson, LG, Techno Trend

dhe Keymat, pau siguruar për prejardhjen e të njëjtëve, edhe pse ka mundur ta dijë se televizorët janë vënë në dorë me antë të vjedhjes dhe nuk janë blerë nga pronari [REDAKTUAR], televizorët janë konfiskuar dhe iu janë kthyer pronarit.

Me të cilën kryen veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 paragrafi 2 KPK-së.

Kundër të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Sepse:

8.1 Me datë 14.03.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën "Epopeja e Jezercit", në Ferizaj, përkatësisht në lokalin e N.P [REDAKTUAR], pronë të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, dy të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes dhe pasi kanë depërtuar brenda kanë marrë një kompjuter dhe atë monitorin e tipit IBM dhe shtëpizëne tipit "Compaq", në vlerë sipas të dëmtuarit 450€.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Sepse:

9.1 Me datën 16.05.2013, në Gjimnazin "Shaban Hashani", në rrugën "Gjon Sereqi", në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, me një mjet të fortë kishin hapur me forcë derën e puntorisë së shkollës dhe nga aty kishin vjedhur një karrocë dore në vlerë prej 25€ dy burmashina në vlerë prej 200€, dy gdhendëse të metaleve në vlerë prej 200€, një motorshalë në vlerë prej 200€, disa vegla punë në vlerë prej 50€.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDACTED]

Sepse:

9.2 Me datën e pavërtetuar ka blerë nga të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] gjësendet e cekura në dispozitivin e parë të këtij aktvendimi edhe pse ka mundur ta dijë se ato sende janë vënë në dorë me anë të vjedhjes sepse janë blerë me çmim të ulët prej 250€ dhe nuk janë blerë nga pronari.

Me të cilën ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së.

Kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED]

Sepse:

10.1 Me datën 12.02.2013 në intervalin kohor të pacaktuar në rrugën "Besim Rexhepi", në Ferizaj në lokalet e kompanisë [REDACTED], pronë e të dëmtuarit [REDACTED] në bashkëveprim e me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm me forcë kanë hapur derën e hyrjes së lokalit kanë hyrë brenda dhe ngaaty kanë marrë: një televizor të markës "Tech line", një kompjuter me shtëpizë dhe monitor, të cilat ia kishin shitur [REDACTED] nga Theranda në vlerë prej 150€, Policia e Kosovës i ka konfiskuar mjetet dhe ia ka kthyer të dëmtuarit.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDACTED]

Sepse:

10.2Gjatë muajti shkurt 2013, në rrugën "Skenderbeu" në Suharekë me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme që vetit të i sjellëpërfitim pasuror të kundërligjshëm ka pranuar-blerë, sende të vjedhura dhe atë: një televizor plazma "Tach line", njëgjyrë e zezë me të bardhë, një monitor të tipit "Samsung" dhe një kompjuter të tipit "Simens", në vlerëtë përgjithshme prej 150€ për të cilat i pandehuri ka mundur ta dijë se janë përfituar me anëtë veprës penale vjedhje.

Me të cilën ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse:

11.1Me datë 22.12.2010 në kohë tëpacaktuar në rrugën "Pjetër Budi", në Ferizaj, përkatësisht në lokalin e agjensionit [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit i pandehuri e ka hapur me forcë derën e hyrjes dhe pasi ka depërtuar brenda ka marrë një kompjuter (shtëpizën dhe monitorin), një faks me telefon dhe një fotokopje, në vlerë sipas të dëmtuarit 845€.

11.2Me datë 03.03.2011 në kohë ta pacaktuar në rrugën "Hamzë Jashari" në Ferizaj, përkatësisht në lokalin e avokaturës, pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit i pandehuri ka hapur me forcë derën e hyrjes dhe pasi ka depërtuar brenda ka marrë një kompjuter komplet të tipit "LG", në vlerë sipas të dëmtuarit 320€.

Me të cilën kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse:

11.3 Me dt. 03.03.2011 në kohë të pacaktuar, në Ferizaj, kishte blerë nga [REDAKTUAR] një monitor për kompjuter të tipit "LG", një tastier me ngjyrë të zezë me mbulesë dhe një fotokopje me ngjyrë të zezë, pa u siguruar për prejardhjen e të njëjtit, edhe pse ka mundur ta dijë se të njëjtit janë vënë në dorë me anë të vjedhjes dhe nuk janë blerë nga pronari [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të njejtat janë konfiskuar dhe iu janë kthyer pronarëve.

Me të cilën ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së.

Kundër të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Sepse:

12.1 Me datë 11.02.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën "Enver Topalli" në Ferizaj, përkatësisht në lokalin NTP [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshmetë tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjeskanë dëpërtuar brenda dhe kanë marrë 50 kg, sheqer, qaj, çokollada "Millka" 50 copa, vaj 15 litra, pije "Redbull" 24 copa, dhe 100 copa cigare të llojeve të ndryshme në vlerëtë përgjithshme sipas të dëmtuarit prej 400€.

12.2 Me datë 03.03.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën "Besim Rexhepi", në Ferizaj, përkatësisht në lokalin [REDAKTUAR] pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes dhe ishin larguar pa marë asgjë.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse :

12.3 Me datë 03.03.2011 në kohë të pacaktuar, në Ferizaj kishte blerë nga [REDAKTUAR] 10 kg qaj, pa u siguruar për prejardhjen e të njëjtit, edhe pse ka mundur të dijë se i njëjti është vënë në dorë anë të vjedhjes, i njëti është konfiskuar dhe i është kthyer pronarit [REDAKTUAR]

Me të cilën ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse:

13.1 Gjatë muajit maj të vitit 2010 në kohë të pacaktuar në Ferizaj në rr."Fan Noli", me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti jellë përfitime pasurore të kundërligjshme në atë mënyrë që përmes kërcënimeve të rënda ka detyruar të miturin [REDAKTUAR] që të veprojë në dëm të pasurisë së tij dhe familjes së tij, duke iu kërcënuar se nëse nuk më sjell të holla dhe gjërame vlerë-stoli arri unë do të të fus në një bure dhe do të të vras, poashtu do ta kallj shtëpinë dhe do ti vras edhe anëtarët e tjerë të familjes, ashtu që ky kërcënim ka shkaktuar shqetësim tek i mituri dhe familja e tij është detyruar i mituri që shpesh ti sjell të holla të pandehurit në shumetë përgjithshme prej 200€ dhe një zingjir të arit në vlerë prej 280€.

13.2

Me të cilën ka kryer veprën penale detyrimi nga neni 267 par.1 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse :

13.3 Me datën e papërcaktuar të muajit maj 2010 e ka blerë nga i pandehuri i parë një zingjir prej arit në vlerë prej 18€ dhe një rreth dore prej ari në vlerë prej 7€ të cilat i

pandehuri i parë i kishtëpërfitur me kryerjete veprës penale detyrimi nda i dëmtuari [REDACTED] edhe pse i pandehuri e ka ditur që këto sende janë përfituar me anë të veprës penale.

Me të cilën ka kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDACTED]

Sepse:

14.1 Më datë 23.12.2015 rreth orës 18:00 në rr. "Vëllezërit Gërvalla", në Ferizaj, në marketin [REDACTED] është ndalur nga menaxheri i marketit për shkak se i dyshuari [REDACTED] në vazhdimësi ka marrë kaffe nga marketi ku përmes kamerave statike është vërejtur nga menaxheri se bëhet fjalë për një sasi kafeje Instant Cafe ku vlera e dëmit sipas menaxherit sillet rreth 250€.

Me të cilën në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED]

Sepse:

15.1 Me datën 09.12.2013, rreth orës 01.30 në Ferizaj, rruga "Ahmet Kaçiku", saktësisht në lokalit e kompanisë [REDACTED] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, të pandehurit në bashkëkryrje me përdorimin e forcës, me një hebëll kanë hapur derën e hyrjes së lokalit, kukanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marr një televizor pllazma të tipit "Gruding", ku mëpas të njëjtin ja kanë shitur të pandehurit [REDACTED] në vlerë 80€ e që më vonë i njëjti i konfiskohet nga ana e policisë dhe i kthehet të dëmtuarit.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDACTED]

Sepse:

15.2 Në dhjetor të vitit 2013, në kohë të pacaktuar në Ferizaj, përkatësisht në lokalit, kafiterin e tij, ku punon nga të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED], ka blerë një televizion plazma të tipit "Gruding", me çmim prej 80€ pa u siguruar për prejardhjen e të njëjtit edhe pse ka mundur ta di se ky televizor plazma është vënë në dorë me anë të kryerjes së veprës penale.

Me të cilën ka kryer veprën penale blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së.

Kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED]

Sepse:

15.3 Me dt.08.12.2013, rreth orës 01.30, në Ferizaj, rruga "Ahmet Kaçiku", saktësisht në lokalit e kompanisë [REDACTED]-pronë e [REDACTED], në bashkëkryerje, kanë dëmtuar pasurinë luajtshme- amstrongat e tavanit, duke i demoluar dhe thyer ku i është shkaktuar dëm të dëmtuarit në vlerë prej 500€.

Me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED]

Sepse:

16.1 Ekziston dyshimi i arsyeshëm së më dt. 26.03.2012 në rrugën "Hamëz Jashari", në Ferizaj, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës kanë thyer xhamin e veturës "Golf 3", me ngjyrë tëzëzë me targë të regjistrimit [REDAKTUAR] pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] kanë depërtuar brenda në të dhe nga aty kanë marrë kasetofonin e veturës të tipit DVD-Radio Player ku vlera e saj sipas të dëmtuarit është rreth 200€.

Me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Kundër të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse:

16.2 Ekziston dyshimi i arsyeshëm se në kohë të pa përcaktuar gjatë vitit 2013 ka pranuar mallrat e përfituar përmes veprës penale vjedhje nga i pandehuri [REDAKTUAR] ka blerë kasetofonin etë tipit "DVD- Rady player", në vlerë prej 6 € edhe pse ka mundur ta di se i njëti është përfituar me vepër penale.

Me të cilën ka kryer veprën penale pranimit i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 241 par. 4 lidhur me par. 1, dhe neneve 4,7,17,21,41,43,45,46, 73 dhe 80 të KPRK-ës, dhe neni 365 të KPPRK-ës, e

G J Y K O N

Për të akuzuarin [REDAKTUAR] i cili në vazhdim dhe në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga nen 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ME DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ 14 /katërmëdhjetë/ MUAJVE, si dhe dënim me GJOBË në shumën prej 500/pesqind/ euro, dhe për veprën penale Detyrimi nga neni 267 par.1 të KPK-së, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 /tre/muaj

Në kuptim të nenit 80 të KPRK-së

GJYKON ME DËNIM UNIK BURGIM

I

Në kohëzgjatje prej shtatë 16 /gjashtëmbëdhjetë muaj/ i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që të akuzuarit për çdo 20 € do të vuajnë nga një ditë burgimi.

Të akuzuarin [REDAKTUAR]:

E gjykon me DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 2/dy/viteve, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej 500/pesqind/ eurove të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën kohore prej 2 viteve nuk kryhen vepër tjetër penale (Koha e verifikimit).

Të dëmtuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest juridiko – civil.

OBLIGOHEN të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën me nga 50 /pesëdhjetë/ €, , si dhe për të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shume secili veç e veç me nga 20 /njëzetë/ €, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit.

OBLIGOHEN të akuzuarit që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguajnë secili veç e veç shumën prej 30€(tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së

II

LIROHET NGA AKUZA

Të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Sepse me dt.15.04.2013 pas mesnate në rrugën "Besim Rexhepi", në Ferizaj saktësisht në shkollënteknike në objektin përcjellës i cili shërben për praktikë të nxënësve, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës kanë thyer një dritare të shkollës, përmes saj kanë depërtuar në kabinetin e shkollës dhe nga aty kanë marrë pajisje të ndryshme si aparat saldues dhe aparate të tjera, pjesëtë gypave, kablo të ndryshme që shërbejnë për mbajtjen e praktikës në kabinetet e shkollës

Meqë nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 327 par.1 nënë par 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Të akuzuarit [REDAKTUAR]

Sepse me datë 15.01.2011 në kohë tëpacaktuar në rrugën "Ahmet Kaqiku" në Ferizaj, përkatësisht në lokalit e Kompanisë së Sigurimeve [REDAKTUAR], me përgjegjës [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, i pandehuri pasi kahapur me forcë derën e hyrjes, ka depërtuar brenda dhe ka marrë 2 kompjuter të markës "Dell", një llaptop të markës "Toshiba", në vlerë sipas të dëmtuarit 1700€.

Sepse me dt.21.01.2011, në kohë të pacaktuar, në rrugën "D. Kombit", në Ferizaj, përkatësisht në lokalin për servisimin e ashensorëve pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit i pandehuri ka hapur me forcë derën e hyrjes ka depërtuar brenda dhe ka marrë 2 kompjuter të markës "Compaq", një televizor Samsung, dy UPS, në vlerë të përgjithshme sipas të dëmtuarit 1.360 €.

Sepse me datë 19.03.2011, në kohë të pacaktuar në rrugën "Besim Rexhepi", në Ferizaj, përkatësisht në lokalin –servisin [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit i pandehuri ka hapur me forcë derën e hyrjes, ka depërtuar brenda dhe ka marrë 7 copë televizor të markës Sek, Samsung, Hentrex, Tompson, LG, Techno Trend dhe Keymat në vlerë të përgjithshme sipas të dëmtuarit prej 2.000€.

Meqë nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Te akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

5.2 Me dt.15.04.2013 pas mesnate në rrugën "Besim Rexhepi", në Ferizaj saktësisht në shkollënteknike në objektin përcjellës i cili shërben për praktikë të nxënësve, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës kanë thyer një dritare të shkollës, përmes saj kanë depërtuar në kabinetin e shkollës dhe nga aty kanë marrë pajisje të ndryshme si aparat saldues dhe aparate të tjera, pjesëtë gypave, kablllo të ndryshme që shërbejnë për mbajtjen e praktikës në kabinetet e shkollës.

Meqë nuk është provuar se te akuzuarit kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Per te akuzuarin [REDAKTUAR]:

4.4 Me datë 06.02.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën “D. Kombit” në Ferizaj, përkatësisht në kioskun e NTP [REDAKTUAR] pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes dhe pasi kanë depërtuar brenda kanë marrë cigare të ndryshme 35 boksa, në vlerë sipas të dëmtuarit 600€ dhe një sasi të kafes së pa bluar.

Meqë nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

III

Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së

REFUZOHET AKUZA

Per te akuzuarin [REDAKTUAR]:

4.5 Me datë 06.12.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën “Ahmet Kaçiku” në Ferizaj, përkatësisht në marketin “[REDAKTUAR]”, pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes dhe pasi kanë depërtuar brenda kanë marrë nga arka 300€ para të gatshme, 3 copë aparata digjital “Fuji-film”, në vlerë prej 300€, Nes Kafe të llojeve të ndryshme në vlerë prej 300€, çokollata “Millka”, në vlerë prej 100€, si dhe cigare të ndryshme në vlerë prej 1000€.

Meqë prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale për veprën penale në vazhdim vjedhje e rënde nga neni 353 par.1 nën par.1 të KPK-së.

Per te akuzuarin [REDAKTUAR]

6.7 Me datë 26.03.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën "Ejup Statovci", në Ferizaj, përkatësisht në lokalit NTP [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë nga arka 100€ para të metalta, cigare të llojeve të ndryshme në vlerë 350€, shampona "Palmolive" në vlerë 40€, vaj në vlerë 30€ dhe qaj në vlerë prej 20€.

Meqe prokurori i shtetit është terhek nga ndjekja penale për veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Për të akuzuarin [REDAKTUAR]:

Sepse me dt.23.shkurt.2011, rreth orës 00.50, në lokalit [REDAKTUAR], në rr."Hamzë Jashari", në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm, për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në atë mënyrë që pas një marrëveshje paraprake në mes tyre, kanë shkuar tek lokali pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], i pandehuri i parë me një hebull ka hapur derën e lokalit dhe së bashku me të pandehurin e dytë kanë hyrë brenda lokalit kurse i pandehuri i tretë ka bërë roje jashtë lokalit, nga aty kanë marrë cigare të llojit "Vinston", "Ronhill", "Davidof", "Klasik" dhe 12 shishe alkool të llojit "Sminori", "Xhek Daniels" dhe "Shtock", ku një pjesë e këtij malli ja shesin të pandehurit [REDAKTUAR]

Sepse me dt.24.mars.2011, rreth orës 02.30, në lokalit [REDAKTUAR], në rr."Dëshmorët e Kombit", në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në atë mënyrë që në bashkëkryerje me përdorimin e forcës kanë hapur derën e lokalit, kanë depërtuar brenda në lokal pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe nga aty kanë marrë 100 orë dore, disa bateri dhe një kuti me rripa të orëve, në vlerë të përgjithshme rreth 2.000€.

3.2 Me dt.09.03.2011, rreth orës 01.00, në rr."Epopeja e Jezercit", në Qendren Tregtare [REDAKTUAR], në kafiterinë [REDAKTUAR] në Ferizaj pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR]

██████ në bashkëkryerje, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetes t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës, kanë thyer derën e lokalit kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marr një TV "Samsung" me vlerë 800 euro dhe një telefon "Nokia" me vlerë 100 euro dhe largohen nga vendi i ngjarjes.

Meqe prokurori i shtetit eshte terhek nga ndjekja penale per veprën penale ne bashkëkryerje vjedhje e rëndë ne vazhdim nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

8.2 Me datë 14.03.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën "Epopeja e Jezercit", në Ferizaj, përkatësisht në lokalit e N.P ██████, pronëe të dëmtuarit ██████ me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, dy të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes dhe pasi kanë depërtuar brenda kanë marrë një kompjuter dhe atë monitorin e tipit IBM dhe shtëpizëne tipit "Compaq", në vlerë sipas të dëmtuarit 450€.

Meqe prokurori i shtetit eshte terhek nga ndjekja penale per veprën penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë ne vazhdim nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

2.7 me date 31.12.2010, rreth orës 08.30 në Feriza, në rr."Besim Rexhepi", në bashkëkryerje me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që me qëllim të përdorimit të forcës kanë hapur lokalit e të dëmtuarit ██████ janë futur brenda dhe nga aty kanë marrë: dy shtëpiza kompjuteri, dy monitorë, një fotokopje, një printer dhe një resever të gjitha në vlerë prej 1818€ dhe janë larguar nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

2.8 me dt.24.01.2011, rreth orës 9.55, në Ferizaj, në rr."Kemajl Hetemi", në bashkëkryerje me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që

vetes t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës kanë hapur lokalit [REDAKTUAR]- pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marrë, 1 TV plazma të tipit "Sëistek", 1 laptop i tipit "Acer" si dhe 15 kilogramë mish, të gjitha në vlerë 760€ dhe janë larguar nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

2.9 me dt.21.02.2011, rreth orës 8.10, në Ferizaj, në rr."Xhemë Gostivari", në bashkëkryerje, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetes t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës e kanë hapur derën e lokalit [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe aty kanë marrë 1 TV plazma e tipit "LG" në vlerë rreth 386€ dhe janë larguar nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

2.10 me dt.22.02.2011, rreth orës 00.30, në Ferizaj, në rr."Ahmet Kaçiku", në bashkëkryerje, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetes t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës kanë hapur derën e kafiterisë [REDAKTUAR] pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marrë 30 kilogram mish, 10 pije alkoolike, 2 nxechëse-kaloriferë, të gjitha në vlerë rreth 550€ dhe janë larguar nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

Prokurori i shtetit ka hequr dore nga akuzat, meqë nuk është provuar se kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje dhe në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Për të akuzuarin [REDAKTUAR]

Sepse:

Me datë 04.11.2011 në kohëtë pacaktuar, në rrugën "Besim Rexhepi", në Ferizaj, përkatësisht në lokalit [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje të pandehurit kanë hapur me

forcë derën e hyrjes, kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë 50 shishe pije alkoolike, në vlerë prej 500€.

Me datë 12.12.2011 në kohë të pacaktuar, në rrugën “Besim Rexhepi”, në Ferizaj, përkatësisht në lokalin [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes, kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë para të metalta rreth 70€ dhe 45 pako pije “Redbull” në vlerë prej 1170€.

Me datë 18.11.2010 në kohë të pacaktuar në rrugën “Ahmet Kaçiku”, në Ferizaj përkatësisht në lokalin NTP [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarës [REDAKTUAR], me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes, kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë artikuj të ndryshëm si : këpucë për femra, sandale të ndryshme, pizhame për femra dhe roba për fëmijë në vlerë të përgjithshme sipas të dëmtuarës prej 800€.

Me dt. 03.03.2011, rreth orës 04.15, në rrugën “Ahmet Kaçiku” në Ferizaj përkatësisht në lokalin NTP [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarës [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes dhe nuk kishin marrë asgjë sepse ishin larguar pasi ishte aktivizuar alarmi.

Me datë 14.03.2011, në kohë të pacaktuar në rrugën “Enver Topalli”, në Ferizaj përkatësisht në lokalin-minimarketin [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes, kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë një arkë në vlerë prej 150€, 40€ para të metalta si dhe cigare të llojeve të ndryshme.

Me datë 26.03.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën “Ejup Statovci”, në Ferizaj, përkatësisht në lokalin NTP [REDAKTUAR], pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes kanë depërtuar brenda dhe kanë marrë nga arka 100€ para të metalta, cigare

të llojeve të ndryshme në vlerë 350€, shampona “Palmolive” në vlerë 40€, vaj në vlerë 30€ dhe qaj në vlerë prej 20€.

4.6 Me dt.08.12.2013, rreth orës 01.30, në Ferizaj, rruga “Ahmet Kaçiku”, saktësisht në lokalin e kompanisë [REDAKTUAR]-pronë e [REDAKTUAR] në bashkëkryerje, kanë dëmtuar pasurinë luajtshme- amstrongat e tavanit, duke i demoluar dhe thyer ku i është shkaktuar dëm të dëmtuarit në vlerë pre Me datë 06.02.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën”Ahmet Kaçiku” në Ferizaj, përkatësisht në marketin [REDAKTUAR], pronë të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë se luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjesdhe pasi kanë depërtuar brenda kanë marrë nga arka 300€ para të gatshme, 3 copë aparata digjital “Fuji-film”, në vlerë prej 300€, Nes Kafe të llojeve të ndryshme në vlerë prej 300€, çokollata “Millka”, në vlerë prej 100€,si dhe cigare të ndryshme në vlerë prej 1000€.

4.7 Me datë 06.02.2011 në kohë të pacaktuar në rrugën”Ahmet Kaçiku” në Ferizaj, përkatësisht në marketin [REDAKTUAR], pronë të dëmtuarit [REDAKTUAR], me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë se luajtshme të tjetrit, në bashkëkryerje, të pandehurit kanë hapur me forcë derën e hyrjes dhe pasi kanë depërtuar brenda kanë marrë nga arka 300€ para të gatshme, 3 copë aparata digjital “Fuji-film”, në vlerë prej 300€, Nes Kafe të llojeve të ndryshme në vlerë prej 300€, çokollata “Millka”, në vlerë prej 100€,si dhe cigare të ndryshme në vlerë prej 1000€.

Meqë prokurori i shtetit eshte tërheq nga ndjekja penale per veprën penale bashkëkryerje në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nënë paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Për të akuzuarin [REDAKTUAR]

Sepse ekziston dyshimi i arsyeshem se më dt.26.03.2012 në rrugën “Hamëz Jashari”, në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit të i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimine forcës kanë thyer xhamin e veturës “Golf 3”, me ngjyrë të zezë me targë të regjistrimit [REDAKTUAR] pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] kanë

depërtuar brenda në të dhe nga aty kanë marrë kasetofonin e veturës të tipit DVD- Radio Player, ku vlera e saj sipas të dëmtuarit sillet rreth 200€.

Meqë prokurori i shtetit është tërheq nga ndjekja penale për veprën penale vjedhje nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Kundër të akuzuarve [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED]

dhe [REDACTED].

Meqë në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit është tërheq nga ndjekja penale për veprat penale vjedhje e rëndë në vazhdimësi nga neni 253 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, ndërsa për të akuzuarin [REDACTED] për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, si dhe për të akuzuarit [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak të veprës penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së, Refuzohet Akuza për të akuzuarin [REDACTED] nga shkak se për këto vepra penale: për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe për veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së ka arritur Parashkrimi ABSOLUT.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka paraqitur aktazuat me nr. PP.nr.855/2011 e dt.27.10.2011, PP.nr.952/2011 e dt.21.11.2011, PP.nr.956/2011 dt.21.11.2011, PP.nr.981/2011 dt.23.11.2011, PP.nr.1066/2011 dt.23.11.2011, PP.nr.1072/2011 dt.23.11.2011, PP.nr.1076/2011 dt.23.11.2011, PP.nr.114/2012 dt.19.06.2012, PP.nr.707/2011 dt.04.04.2012, PP.nr.932-3/2012 dt.19.09.2012, PP/II.nr.1218-4/2013 dt.18.12.2013, PP/II.nr.1222-6/2014 dt.13.05.2015, PP/II.nr.1226-4/2014 dt.08.06.2015, PP/II.nr.3049-1/2014 dt.09.12.2015, PP/II.nr.1221-05/2014 dt.13.06.2016, PP/II.nr.2509-4/2015 dt.16.09.2016, kundër të akuzuarve [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] për shkak se nëbashkëkryerje dhe në vazhdim kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së,

si dhe të akuzuarve [REDACTED], [REDACTED] [REDACTED] dhe [REDACTED], për shkak të veprave penale pranimit të mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së, prokurori i shtetit bëri Rikualifikimin e veprës penale në kuptim të nenit 81 të KPRK-së, i cili parasheh denim për veprat penale në vazhdim dhe atë paragrafi 1 i këtij neni i cili pasi që veprat penale në vazhdim përbëhen nga disa vepra të njejta apo të ngjajshme dhe të kryerane lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes dhe të cilat kanë së paku dy kushte:objekti i njejtë të veprës penale dhe dhashjen e njejtë të kryesve dhe pasi që është në favor të të akuzuarve e bëri Rikualifikimin nga vepra penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nënë par.1 të KPK-së dhe veprave penale nga neni 325 par.1, dhe 327 par.1 nënë par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në Veprën penale vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 par.1 nën par.1 .1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur sencën e shqyrtimit fillestar me datën 03.10.2017 si dhe shqyrtimet gjyqësor 14.02.2018, 23.03.2018, 10.05.2018 dhe 21.06.2018.

Gjykata pasi që ka vërejtur se është duke u zhvilluar procedura për të akuzuarit të cilët shumicën e veprave penale i kanë kryer në bashkëkryerje konform dispozitave të nenit 35 par.1 të KPPRK-se ka bashkuar procedurën për veprat penale si dhe për aktakuzat e lartë cekura.

Ndërsa sa i përket të akuzuarit [REDACTED] ka veqar procedurën me aktvendim të veqante pasi që i njëjti në baze të memorandumit zyrtar nga policia pas verifikimit jemi njoftuar se i njëjti gjendet jashtë shtetit të Kosovës përkatësisht në Gjermani.

Ndërsa për të akuzuarin [REDACTED] gjykata ka sjelle aktvendim të veqante për shkak të parashkrimit të veprës penale pranimit të mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas këtyre aktakuzave caktoi dhe mbajti sencën e shqyrtimit gjyqësor më dt. me datë 21.06.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari [REDACTED] e pranon fajësinë sipas aktakuzave: PP.nr.114/2012 e dt. 19.06.2012, PP.nr.855/2011 e dt.27.10.2011, PP.nr.932-03/2012 e dt. 19.09.2012, PP.nr.952/2011 e dt. 21.11.2011, PP.nr.1221-5/14 e dt. 13.06.2016, PP.nr. 1222-6/14 e dt. 13.05.2015, PP.nr. 3049-1/14 e*

dt.09.12.2015, PP.nr. 1072/2011 e dt. 23.11..2011, për veprat penale penale të kryer në vazhdimësi të cilën e ngarkojn aktakuzat për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdëshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i akuzuari [REDACTED] e pranon fajësinë sipas aktakuzave: PP.nr.114/2012 e dt. 19.06.2012, PP.nr.855/2011 e dt.27.10.2011, PP.nr.932-03/2012 e dt. 19.09.2012, PP.nr.952/2011 e dt. 21.11.2011, PP.nr.1221-5/14 e dt. 13.06.2016, PP.nr. 1222-6/14 e dt. 13.05.2015, PP.nr. 3049-1/14 e dt.09.12.2015, PP.nr. 1072/2011 e dt. 23.11..2011, për veprat penale penale të kryer në vazhdimësi të cilën e ngarkojn aktakuzat për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdëshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarve, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe t'iu shqipton dënimin e merituar.

Me që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë ne fjalën perfundimtare janë deklaruar se shprehin keqardhje dhe janë penduar thelle duke shtuar se veprat penale te cilat i kane kryer kane kaluar nje kohe nga kryerja e veprës penale dhe i kane premtuar gjykatës se nuk do te përsërisin vepra te tilla te ngjashme penale, e kane lutur gjykatën ti shqiptoje nje dënim sa me te bute.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 326 par.1 lidhur me nenin 248 par.1 të KPPK-së të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të pandehurit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lëndës.

Me qenë se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 326 par.1 lidhur me nenin 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

I akuzuari [REDACTED] ne mbrojtjen e tij nuk e ka pranuar fajësinë duke pretenduar se nuk i kryer veprat penale dhe ka kërkuar nga gjykata që ta liron nga akuza meqë me asnjë prove nuk është provuar se ai ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet

Pasi që i akuzuari [REDACTED], nuk e ka pranuar fajësinë, për aktakuzën PP.nr.1066-2011 e datës 23.11.2011 për dispozitivin e parë dhe të tretë, andaj gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, vërtetohet gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

I dëmtuari-dëshmitari [REDACTED]

Nga leximi i deklaratës së dëshmitarit-[REDACTED]

Nga mendimi i ekspertit të daktiloskopisë i datës 21.01.2011

I dëmtuari-dëshmitari [REDACTED] ka deklaruar se në mëngjes kur kishte shkuar në lokal përkatësisht në kompaninë e sigurimeve [REDACTED] kishte vërejtur se dera kishte qene e hapur me force dhe kishin munguar monitorë të kompjuterëve shtëpizat e kompjuterëve dhe kabllot kishin qene të shkëputura të gjitha këto kishin qene prone e kompanisë "[REDACTED]" e po ashtu ka shtuar se edhe një laptop i djalit të tij ku kishin qene të gjitha punimet e studimeve i kishte pasur në atë laptop dhe demë kishte qene i mjadh pasi të gjitha i kishin humbur, por i njëjti ka potencuar se nuk e din se kush e ka thyer lokalin e, edhe sot nuk e din se kush i ka marrë gjësendet të cilat i kishin vjedhur.

Dëshmitari [REDACTED] ka deklaruar se në zyrën e tij në rrugën "Dëshmoret e Kombit" përballë shkollës teknike në Ferizaj kishin hyre disa persona të panjohur dhe me force e kishin thyer lokalin ku kishin vjedhur dy kompjuterë "Plazma" në vlerë prej 560 eurove dhe një TV "Plazma samsung" në vlerë prej 700 eurove dhe dy "UPS Smart" 100 euro. Dëshmitari në deklaratën e tij ka potencuar se nuk ka dyshuar në askënd dhe nuk e din se kush janë personat të cilat i kanë thyer lokalin me force.

Nga ekzaminimi i gjurmeve vijave papilare te fiksuara me inicialet F-1 pasi qe sistemi i AFIS i ka dhene disa kandidate per krahasim kanç konstatuar se gjurma e vijave papilare F-1 eshte identike {i përket} gishtit te madh nr.6 te dorës se majte te personit [REDAKTUAR] i lindur me datën [REDAKTUAR] me numër te karteles dhjetë gishterore KSO 2611 OR, dhe pasi qe eshte daktiloskopuar per vepra penale per vjedhje te rëndë dhe eshte vërtetuar se me gishtin numër 6 {gishti i majtë}, i personit [REDAKTUAR] i lindur me datën [REDAKTUAR]

Gjykata i ka shpreh besimin deklarateve te deshmitareve-demtuarve e posaçërisht nga ekzaminimi i vijave papilare te gishterinjeve me te cilat është vërtetuar se [REDAKTUAR] nuk e ka kryer veprën penale

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 par.1 nën par.1 .1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 dhe nenin 74 të KPRK-së, gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes nen minimumin e parapare ligjor per te akuzuarin [REDAKTUAR] nga tri vite ne 16 muaj burg dhe per te akuzuarin [REDAKTUAR] nga tri vite ne dënim me kusht dy vite burg i cili nuk do te ekzekutohet nëse ne periudhën kohore prej dy viteve nuk kryen vepër tjetër penale dhe gjeti si rrethanë veqanarisht lehtësuese se në shqyrtimin gjyqësor kanë pranuar fajësinë, per veprat penale—aktakuzat te larteshenuara duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprat penale të kryera, janë të gjendjes së varfër ekonomike, kalimi i kkohe nga kryerja e veprave penale. Ndërsa per te akuzuarin [REDAKTUAR] po ashtu edhe gjendejn shendetesore te tij i cili ne baze te raporteve mjekesore e po ashtu edhe te Institutit te Forenzikes Psikiatrike eshte i gjendjes shendetesore jo te mire, si rrethana veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi se të akuzuarit janë Recidivistë (përsëritës së veprës penale) të cilët edhe më herët janë dënuar me aktgjykim të formës së prerë [REDAKTUAR] me numër te lëndes P.nr.492/11 te datës 23.06.2011, [REDAKTUAR] me numër te lëndes 439/15 te datës 09.02.2018, për vepra të njëjta penale, shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurve i'u shqiptoi dënim si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në

raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurve.

Sa i përket pjesës së dytë (II)

të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës Liruese, Gjykata në kuptim të nenin 363 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së, të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II-nr.1218-4/13 e dt 18.12.2013, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin.31 të KPPRK-së,

Të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ne mbrojtjen e tyre nuk e kanë pranuar fajësinë duke pretenduar se nuk i kanë kryer veprat penale dhe kanë kërkuar nga gjykata që ti liron nga akuza meqë me asnjë prove nuk është provuar se ata kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen.

Pasi që i akuzuari [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nuk e kanë pranuar fajësinë, për aktakuzën PP.nr.1218-4/2013 të datës 18.12.2013, andaj gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, vërtetohet gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- I dëmtuari- përfaqësuesi i shkollës [REDAKTUAR]
- përmes deklaratës së dëshmitarit [REDAKTUAR]
- nga leximi i deklaratës së dëshmitarit [REDAKTUAR]
- nga leximi i deklaratës së dëshmitarit [REDAKTUAR]

I dëmtuari-dëshmitari [REDAKTUAR] ka deklaruar se në shkollën në të cilën është kryer vepra penale ka qenë profesor në shkollën "Pjeter Bogdani" dhe ende punon aty si mësimdhënës i praktikës profesionale, duke shtuar se gjësendet e vjedhura ishin kthyer por nuk e din se nga kush i kanë marrë.

Dëshmitari [REDACTED] ka deklaruar se nuk ka qene punëtor i kesaj shkolle ku ishte kryer vepra penale, por kishte qene duke punuar te tregu i gjelbër duke përshkruar ngjarjen se i kishte pare dy persona si te dyshimt dhe e kishte lajmëruar stacionin policor, te cilët persona kane pasur ne dore nje qese te zeze dhe kishin hyre e dale ne nje shtëpi te pa banuar, nuk ka mundur ta dije se kush kane qene personat e po ashtu edhe ne shqyrtimin gjyqësor ka potencuar se edhe sot nuk i njeh personat dhe nuk i kishte pare se personat ishin kthyer per ta marre qesen.

Dëshmitari [REDACTED] ka deklaruar se ne deponine e tij e cila gjendet afër tregut kishin shkuar dy persona te moshës 25-30 vjecar i kishin sjelle disa pjese te ujësjellësit te cilat i kishte blerë nga ata dhe menjëherë e kishte lajmëruar stacionin policor pasi qe kishte dyshuar se te njëjtat janë te vjedhura. Meqe i njëjti nuk kishte shënime se nga kush i kishte blere gjësendet deklaroi se personat nuk i njeh.

Dëshmitari [REDACTED] ka deklaruar se deri sa i njëjti kishte qene me disa kolege te punës ne nje objekt ndërtimi te tregu i gjelbër kishin vërejtur dy persona qe kane qene duke bartur nje qese te zeze ne dore përkatësisht nga tregu ne drejtim te autoshkolles dhe ne ato momente ka qene duke kaluar nje veture e policisë dhe pasi qe te njetit e kishin vërejtur veturën e policisë kishin hyre kishin lene qesen mbrapa nje veture dhe pasi vetura e policisë kishte kaluar te njëjtit ishin kthyer dhe kishin marre qesen, dhe i njëjti menjëherë e kishte lajmëruar rastin ne polici.

Gjykata pas vlerësimit të këtyre provave një nga një dhe në lidhshmëri reciproke njëra me tjetrën gjeti se nuk është provuar se te pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata vlerësoi se si faktor me rëndësi në këtë çështje padyshim dëshmia e dëshmitarëve, [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], të cilat gjykata i vlerësoi si të besueshme sepse të njëjtit kanë shpjeguar rastin dhe ne deklaratimet e tyre vetëm kanë potencuar rastin se kanë parë dy persona por gjykata nuk ka vërtetuar gjendejn faktike se kush kanë qene personat dhe emrat e peronave.

Gjykata ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarit nuk janë manifestuar asnjë nga elementet e veprës penale vjedhje e rende nga neni 327 par 1 nen par 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, kjo nuk është vërtetuar në asnjë rrethanë meqë nuk është vërtetuar se është ka kryer

veprën penale për të cilën e ngarkon akuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj nga deklarata e dëshmitarëve.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodit dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë "*in peius*" ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë "*in favorem*" ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Sa i përket pjesës së tretë (II) të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës Liruese, Gjykata në kuptim të nenin 363 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së, të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II-nr.1218-4/13 e dt 18.12.2013, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin.31 të KPRK-së, si dhe të akuzuarin [REDAKTUAR] të akuzuar sipas aktakuzaës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1066/2011 e dt. 23.11.2011, për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nënpar.1 të KPK-së, duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nuk ekzistojnë tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin.31 të KPRK-së, andaj në mungesë të provave të njejtit i liroj nga akuzat, sikurse nën dispozitivin II të aktgjykimit.

Sa i përket pjesës së tretë (III) të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues, Prokurori i Shtetit, është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarve [REDAKTUAR] për akuzën PP.nr. 114/12 e dt. 19.06.2012 për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e

rëndë në vazhdimësi nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, si dhe të akuzuarit [REDAKTUAR] par akuzën PP.nr. 956/2011 e dt. 21.11.2011, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë në vazhdimësi nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, si dhe të akuzuarit [REDAKTUAR] sipas aktakuzës PP/II.nr.1226-4/14 e dt.08.06.2015, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë në vazhdimësi nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës deklarata e të pandehurve, nuk është vërtetuar se të pandehurit kanë kryer këto vepra penale, për të cilat akuzohen, andaj meqenëse nuk kanë mundur të vërtetohen dhe të provohet fajësia e të njetive ashtu siç është përshkruar në dispozitivat e këtyre aktakuzave heq dorë nga ndjekja penale për të pandehurin [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ndërsa poashtu për të akuzuarin [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, si dhe për të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale pranimit i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së, Refuzohet Akuza nga shkak se për këto vepra penale: për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe për veprën penale pranimit i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së ka arritur Parashkrimi ABSOLUT.

Në bazë të nenit 450 të KPPK-ës shpenzime sa i përket pjesës nën III të aktgjykimit do të paguhet nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.285/13 dt.20.07.2018

Zyrtare ligjore,

Ganimete Avdiu

Gjyqtari,

Hakile Ilazi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, nga data e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.